

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 28 dhe nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga **ERSTE GROUP BANK AG**, me seli zyrtare në Vjenë, në adresën: Am Belvedere 1, 1100 Vjenë, Austri, përmes Shoqërisë së Avokatëve Debarliev, Dameski, Qeleshoska nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 02.06.2025, mori këtë

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin **ERSTE GROUP BANK AG**, me seli zyrtare në Vjenë, në adresën: Am Belvedere 1, 1100 Vjenë, Austri, do të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë dhe të vetëm mbi **Santander Bank Polska S.A.**, me seli të regjistruar në adresën 17 Aleja Jana Pavła II, Varshavë, Poloni, edhe bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në shumë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria për pagesë 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3. Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 04.06.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua një njoftim për përqendrim nga **ERSTE GROUP BANK AG**, me seli zyrtare në Vjenë, në adresën: Am Belvedere 1, 1100 Vjenë, Austri, me të cilin **ERSTE GROUP BANK AG** do të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë dhe të vetëm mbi **Santander Bank Polska S.A.**, me seli të regjistruar në adresën 17 Aleja Jana Pawła II, Varshavë, Poloni, përmes shitblerjes së aksioneve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimi të tij dhe bazuar në të dhënat e dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe anekset e tij, konstatoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

ERSTE GROUP BANK AG, është shoqëria amë e një grupi austriak për shërbime financiare që ofron shërbime bankare dhe financiare në Evropën Qendrore dhe Lindore.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Erste Holding ka tre shoqëri të varura të regjistruara:

- SHPARKASE BANKA SHA Shkup, me seli të regjistruar në rr. Vasil Iljoski nr. 14, Shkup - Qendër, me veprimtari të regjistruar: 64.190 – Ndërmjetësim tjetër monetar;
- Shoqëria për lizing SHPARKASE LIZING SHPK Shkup, me seli të regjistruar në rr. Maqedonia nr. 34, Shkup – Qendër, me veprimtari të regjistruar: 64.910 – Lizing financiar;
- S-AMC1 SHPKNJ Shkup - në likuidim, me seli të regjistruar në rr. Maqedonia nr. 34, Shkup – Qendër, me veprimtari të regjistruar: 68.110 – Blerja dhe shitja e pasurive të paluajtshme vetanake.

Santander Bank Polska S.A., aktualisht kontrollohet plotësisht nga shoqëria spanjolle Banco Santander, S.A. Santander Bank Polska S.A. është një bankë universale polake që ofron produkte në fushat e financimit, kursimit dhe investimeve, si dhe një spektër shërbimesh shtesë. Santander Bank Polska S.A. operon ekskluzivisht në Poloni dhe ofron shërbime për persona fizikë, si dhe për ndërmarrje të vogla e të mesme dhe klientë korporativë. Santander Bank Polska S.A. është gjithashtu aktive në mënyrë indirekte përmes filialeve ose ndërmarrjeve të përbashkëta në aktivitetet e faktoringut, lizingut, sigurimeve dhe menaxhimit të aseteve.

Santander Bank Polska S.A. dhe Grupacioni Santander Bank Polska S.A. nuk kanë prani komerciale në Maqedoninë e Veriut, nuk kanë shoqëri të varura apo filiale të regjistruara dhe nuk kryejnë shitje në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, sepse plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe pika 2) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij vendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE
Mr. Малинка Силјановска Николиќ